



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për shërbimet ajrore.” (*Komision përgjegjës*)

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Halit Valteri dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi dhe Lefter Koka,

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile – Drejtoreshë e OSHEE-së

Brikena Jazxhi – Përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Krislen Keri - Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil

Lilika Radovicka - Përgjegjëse Sektori

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të datës 10.06.2019, ora 11:00.

Sot kemi shqyrtimin dhe miratimin e projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”. Relator është zoti Ardit Konomi. Ky akt ka ardhur në Kuvend në datën 19.04.2019 dhe do të shqyrtohet në seancën e datës 20.06.2019.

Të ftuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës janë: zoti Artan Shkreli, zëvendësministër; zoti Krislen Keri, drejtor i Përgjithshëm, dhe zonja Lirika Radovicka.

Po ia jap fjalën relatorit, zotit Konomi, për një prezantim të shkurtër dhe më pas përfaqësuesit e ministrisë do të bëjnë parashtrimin e marrëveshjes në mënyrë sintetike. Më pas do të vazhdojmë me pyetje diskutime dhe në fund me miratimin e kësaj marrëveshjeje.

Ardit Konomi – Faleminderit!

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverisë së Mbretërisë Saudite për shërbimet ajrore. Kjo marrëveshje ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror dhe pritet të ndikojë në krijimin e kushteve të përshtatshme të ndërsjella lehtësuese për operatorët e transportit ajror të të dyja vendeve, si dhe kalimin transit nëpërmjet territoreve të tyre, me qëllim lëvizjen pa pengesë të shtetasve të të dyja palëve.

Detyrimi për këtë marrëveshje është koordinimi i veprimtarisë në fushën e aviacionit civil dhe rrjedh nga qenia palë e Konventës së Çikagos për Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

Arsyet e bindjes së palëve, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverinë së Mbretërisë Arabisë Saudite, janë: promovimi i një sistemi aviacioni ndërkombëtar, bazuar në konkurrencën ndërmjet linjave ajrore në treg me ndërhyrjen minimale të qeverive; lehtësimi i zgjerimit të mundësive të shërbimeve ajrore ndërkombëtare; bindja që shërbimet ajrore ndërkombëtare konkurruese dhe efikase ndikojnë në rritjen e tregtisë dhe në zhvillimin ekonomike, si dhe garantimi i një shkalle më të lartë sigurie dhe mbrojtja e shërbimeve ajrore ndërkombëtare.

Bashkëpunimi në fushën e transportit ajror konsiston dhe orientohet nga parimi i krijimit të komunikimit ndërmjet vendeve, gjë që justifikon edhe iniciativën e nisur për të

realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Marrëveshja ka disa aspekte kryesore: dhënien e të drejtave; fasilitetet dhe tarifet aeroportuale; parimet drejtuese të shërbimeve të miratuara; sigurinë ajrore; sigurimin e aviacionit; tarifet e tjera.

Përveç Arabisë Saudite, Shqipëria ka marrëveshje të ngjashme me Bashkimin Europian dhe me shtete të tjera, si me Zvicrën, Kuvajtin e të tjera.

Për lehtësitë që parashikohet të sjellë kjo marrëveshje ndërmjet dy vendeve dhe për faktin se është punuar me shumë seriozitet nga grupi i punës, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zoti Konomi!

Zoti Shkreli, a keni diçka për të shtuar te prezantimi, apo do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime nga anëtarët?

Artan Shkreli – Kam vetëm një gjë shumë të shkurtër.

Në thelb, kjo është një marrëveshje rutinë, nuk është një marrëveshje e veçantë në raport me marrëveshjet paraardhëse, që janë në këtë sektor. U përmend pak nga relatori që marrëveshje të ngjashme kemi edhe me vendet e Bashkimit Europian dhe me shumë vende të tjera, por edhe me vende si Kuvajti. Të gjitha vendet e rajonit tonë kanë marrëveshje me këtë vend. Kemi pasur një kontestim nga një deputete e opozitës në Komisionin e Jashtëm, që tha se Arabia Saudite është vend problematik, por kjo nuk përkon me listimin e këtij vendi, qoftë nga Bashkimi Europian, qoftë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë edhe nga rajoni ynë.

Për sa i përket pjesës tjetër, dua të them se kjo marrëveshje nuk ka efekte financiare, pra është një marrëveshje që hyn në fuqi pa pasur një faturë financiare të ndërsjellë. Për elementet teknike ose ligjore, nëse ka pyetje, jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Shkreli!

Ka pyetje?

Po, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Fillimisht, kryetar dhe kolegë, ndoshta jam jashtë rendit të ditës, por nga sot kemi një situatë të re. Kështu që, pa dashur t'i shmangemi seriozitet të çështjes që po diskutohet, gjithsecili duhet të reflektojë për atë që mund të vijë nga deklarata e sotme e Presidentit të Republikës.

U përpoqa ta lexoj dekretin sot dhe për mua ai dekret është nul, aq më tepër që, nëse hyjmë në atë logjikë, i bie që unë do të rri në këtë komision 20 vjet, nëse ai do të shpallë zgjedhje të tjera. Kemi hyrë në një logjikë shumë infantile. Sigurisht, ne duhet të diskutojmë realisht në seancën e së enjtes për situatën konkrete, por edhe për precedentin shumë të papranueshëm, që mund të krijojë fillimi i zbatimit të këtyre normave, që e bëjnë pastaj vendin të paqeverisshëm.

Për marrëveshjen, nëse mundem, është edhe në tekst, por sapo e tha edhe zëvendësministri, që nuk krijon efekte shtesë për buxhetin.

Neni 6 i marrëveshjes mos krijon efekte negative për të ardhurat e buxhetit të shtetit, sepse këtu bëhet fjalë për përjashtime? Sigurisht, nëse do të paguhen më pak taksa, në njëfarë mënyre, për balancimin e buxhetit në pamje të parë duket sikur e dyta... A i kemi parimet e nenit 6 edhe në marrëveshje të tjera të ngjashme, që ka firmosur Shqipëria me vendet që ju përmendët?

Meqenëse jemi te çështjet e aviacionit, edhe pse nuk është drejtpërdrejt e lidhur me këtë marrëveshje, por, në fund të fundit, këta avionë, në qoftë se fillojnë të operojnë, në Rinas do të ulen, të paktën edhe për një vit e gjysmë. Nëse mund të na thoni edhe diçka, që na është thënë në këtë komision korrikun e kaluar, pra që për marrëveshjen aktuale të koncesionit keni filluar një procedurë vlerësimi dhe auditimi, por në ç'fazë është ky vlerësim apo auditim?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Këto marrëveshje janë periodike apo bëhen një herë dhe vazhdojnë ?

Pyetja e dytë: a krijon premisa edhe për një linjë ajrore, apo nuk ka interes?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Shkreli, ju lutem, a mund të përgjigjeni?

Artan Shkreli – Për sa i përket observacionit të parë që bëri zoti Beqaj, kjo marrëveshje, duke iu referuar gjithmonë nenit 6, pa dashur të përsëris arsyetimin, është ratifikuar në nivele ndërkombëtare për të gjitha vendet, pra ka reciprocitet për çështjen e detyrimeve doganore apo lehtësirave. Të njëjtën gjë, që na bëjnë ne vendet, me të cilat kemi marrëveshje të ngjashme, ua bëjmë ne të tjerëve. Kjo është ratifikuar nga WTO-ja dhe është një marrëveshje kuadër e të gjitha vendeve, që e kanë bërë këtë ratifikim. Në njëfarë mase, le të themi se ky lloj lehtësimi është obligator dhe është *vice versa*, pra edhe të tjetër për ne.

Po i kthej përgjigje edhe pyetjes se si jemi ne raport me vendet e tjera, jo thjesht me Arabinë Saudite.

Për kërkesën për një sqarime se çfarë po bëhet në raport me kushtet e sigurisë në aeroport, duke iu referuar...

(Deputeti Ilir Beqaj flet pa mikrofon)

Ilir Beqaj - ...para një viti, pa ndodhur incidenti në Rinas, ka qenë një përpjekje për të bërë një vlerësim të termave ekonomike të marrëveshjes në përgjithësi, kurse kjo është pjesë e sigurisë...

Artan Shkreli – Këtu do t'ia jap fjalën zotit Keri, i cili mund të japë elemente më të azhurnuara, sepse është njeriu që merret çdo ditë me këtë pjesë, menjëherë pasi të jap përgjigjet e dy pyetjeve që bëri edhe zoti Baraj.

Për sa i përket periodicitetit të marrëveshjes, marrëveshja nuk është periodike. Këto lloj marrëveshjesh bëhen një herë, por azhurnohen mbi bazën e elementeve të reja, të cilat hiqen apo shtohen në varësi të kërkesave.

Duhet thënë se qëllimi i marrëveshjes është krijimi i linjës midis Arabisë Saudite, pra një linjë e re fluturimesh, e cila duhet të fillojë sa më shpejt. Gjithashtu, ka një interes të rritur kryesisht nga biznesi i Arabisë Saudite, si dhe pritet një lloj fluksi turistik edhe nga ata, por kryesore janë fluturimet, që do të bëhen nga shumë grupe, nga të cilat Shqipëria ka interes në pikëpamjen ekonomike. Natyrisht, marrëveshja i hap rrugë vendosjes së linjës midis dy vendeve dhe, për hir të së vërtetës, Shqipëria është i vetmi vend në rajonin tonë, që nuk ka një linjë direkte me Arabinë Saudite, pra futemi edhe ne në gjeografinë e tyre të Ballkanit.

Për sa i përket pyetjes së dytë të zotit Beqaj, po ia lë fjalën zotit Keri.

Krislen Keri – Faleminderit!

Për referimin tuaj të para disa kohëve në raportim në këtë komision për trajtimin e problematikave të koncensionarit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, duhet t'ju informoj se prej kohësh qeveria ka qenë në ndjekje të këtyre problematikave në disa aspekte: në aspektin operacional, në aspektin e sigurisë në aviacion dhe në aspektin tregtar. Ai që përmendet ju, është aspekti tregtar. Të tria këto çështje janë subjekt i punës së konsulentit ligjor ndërkombëtar i kontraktuar nga qeveria para disa javësh në lidhje me organizimin dhe rekomandimin e qeverisë për hapat e mëtejshëm, si dhe për adresimin e këtyre problemeve.

Në këtë moment po punon konsulenti ndërkombëtar dhe në një moment të dytë mund të jemi në gjendje t'i përgjigjemi më saktë pyetjes suaj.

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Mund të na informoni për afatet e pritshme të gjetjeve të konsulencës?

Klisen Keri –Patjetër, për sa na takon neve të Aviacionit Civil, duke iu referuar kërkesë suaj, mund të vendosemi në kontakt me Avokaturën Shtetit, e cila po e ndjek si procedurë...

Ilir Beqaj – Kur pritet të mbarojë?

Klisen Keri – Kjo procedurë po ndiqet nga Avokatura e Shtetit, por ne mund të marrim një informacion dhe t’ju sjellim zyrtarisht.

Niko Peleshi – Ka një pyetje zoti Valter.

Halit Valteri – Vazhdoni, ju lutem!

Artan Shkreli – Do ta sjellim menjëherë informacionin. Kjo mund t’ju duket sikur do të shihemi radhën tjetër, por mund të mos shihemi shpejt. Domethënë, me daljen nga kjo mbledhje, sepse unë tani po e marr vesh që kjo gjë po ndiqet nga Avokatura e Shtetit në këtë fazë, ne do të lidhemi direkt me Avokaturën e Shtetit dhe besoj se brenda ditës së sotme do të jemi në gjendje t’ju japim disa terma kohor!

Halit Valteri – Meqë jemi te pritja, kam një pyetje zoti Shkreli. Meqenëse punimet me koncesionarin turk për aeroportin e Vlorës kanë dështuar, si po ecin ato? Shqiptarët kanë tarifatat më të larta në rajon në aeroportin “Nënë Tereza”, çfarë mund të bëhet për këtë?

Artan Shkreli – Sa i përket çështjes së aeroportit të Vlorës, bisedimet për koncesionimin e këtij aeroporti me operatorin turk janë ndërprerë pasi, në fazën përmbyllëse të tyre, pala turke i shtroi palës shqiptare kërkesa të papranueshme për sa i përket kompensimit që duhet të bënte shteti shqiptar në disa modalitete, të cilat ishin trajtuar më përpara dhe që janë mbyllur. Ka qenë një kërkesë e papritur e tyre në fazën përmbyllëse të negociatave, ku ka marrë pjesë personalisht zoti Keri, që kam këtu në krah. Në njëfarë mënyre u duk sikur ishte një kërkesë shtesë pikërisht për të bërë tërheqjen, pasi ishin mbyllur nga pikëpamja financiare, ashtu dhe operacionale, pra se si do të vendosej. Kjo kërkesë ka ardhur në fazën përmbyllëse të kontratës, domethënë, ishte rënë dakord paraprakisht për kontratën pas negocimit dhe, në momentin që kjo kontratë do të kalonte për t’u shkuar referencave teknike dhe juridike, pra homologimit me gjërat e tjera, erdhi kjo kërkesë e papritur.

Në fazën që jemi po përgatiten termat e referencës për ta tenderuar çështjen e aeroportit të Vlorës në nivel ndërkombëtar, kërkesë e cila ka ardhur nga shumë operatorë, kryesisht nga vendet e BE-së, që kanë shprehur interes për këtë aeroport, ndërkohë që zhvilloheshin negociatat me palën turke. Kështu që, informacioni i fundit është pikërisht përgatitja e termave të referencës për ta tenderuar në nivel ndërkombëtar.

Për pyetjen e dytë po lë zotin Keri të japë shpjegime për sa i përket çështjes së tarifave në aeroportin e Rinasit, se janë ende të larta.

Krislen Keri - Atëherë, siç është referuar edhe herë tjetër në këtë komision, por edhe në komisione të tjera në lidhje me strategjinë e qeverisë për adresimin e problematikës që ju sapo përmendët, qeveria nuk mund të ndërhyjë drejtpërdrejt tek tarifat në aeroportin e Tiranës për shkak të kontratës së koncesionit që ata kanë, prandaj liberalizimi i tregut të ofrimeve të shërbimeve të aeroporteve ndërkombëtare në vend ka qenë pjesë e strategjisë. Siç mund të jeni vënë në dijeni, kjo strategji ka filluar që prej heqjes së ekskluzivitetit të aeroportit ndërkombëtar. Në dijeninë time punimet kanë filluar pas nënshkrimit të kontratës koncesionare për rindërtimin dhe dhënien për operim të aeroportit të Kukësit. Ky do të jetë një aeroport i cili do të adresojë kryesisht fluturimet që kërkojnë kosto të ulët, struktura e koston që do të ofrojë ky aeroport do të jetë me kosto të ulët pasi atje investimi është kryer dhe, meqë këtu jemi në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese dhe specialiteti juaj është çështja e tarifave, struktura e koston së tarifave portuale varet nga investimet që kryhen, pra, në momentin që kemi një investim ajo zbritet nga struktura e koston dhe rrjedhimisht koston dalin më të ulëta.

Brenda 24 muajsh nga nënshkrimi i kontratës fillon operimi në aeroportin e Kukësit. Urojmë që kjo periudhë të jetë më herët me shpresën që punimet do të ecin mirë! Elementi i dytë të liberalizimi i ofrimit të shërbimeve aero portuale ndërkombëtare është aeroporti i Vlorës, i cili është një projekt shumë *feasible* dhe shumë interesant bazuar në disa studime fizibiliteti që kemi nga dy burime të ndryshme. Prandaj kontrata që duhet të merrnim nga ky partneritet duhet të ishte një nivel shumë i lartë, për këtë arsye do të hapet dhe tenderi ndërkombëtar, të cilin po e presim, pasi edhe interesi është shumë i lartë.

Këto aeroporte në treg do të nxisin faktorët e ekonomisë së tregut duke ulur dhe çmimet.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zoti Keri!

Kjo ishte një pyetje jashtë marrëveshjes, por po shfrytëzojmë prezencën e dy përfaqësuesve të lartë të ministrisë.

A ka ndonjë pyetje tjetër brenda temës?

Nuk ka.

Faleminderit për prezantimin!

Kalojmë në miratimin në parim, nen për nen dhe në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Kush është dakord me nënin 1, sipas variantit nga Këshilli i Ministrave?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nënin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Më këtë votim e mbyllim këtë seancë të miratimit të këtij projektligji.

Pas një pushimi do të kemi një seancë tjetër për shqyrtimin dhe miratimin e një marrëveshjeje tjetër të rëndësishme. Kështu që do t’ju lutesha që të rifillojmë pas 5 minutash!

Faleminderit!

(Rifillon mbledhja)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Halit Valteri dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi dhe Lefter Koka,

Niko Peleshi – Ora është 11:30 e datës 10.06.2019.

Në këtë seancë të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit do të shqyrtojmë dhe votojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”

Relatore për këtë projektligj është zonja Eglantina Gjermeni.

Ky akt ka ardhur në Kuvend në datën 23.05.2019 dhe po shqyrtohet sot kurse në seancë do të shqyrtohet në datën 20.06.2019.

Nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës kemi Zëvendësministrin, zotin Ilir Bejtja, zotin Enea Karakaqi, drejtor në ministri, zonja Ilda Malile, drejtoreshë pranë OSHEE-së dhe Brikena Jazxhi nga Ministria e Financave.

Zonja Gjermeni, mund të bëni prezantimin, më pas do të kalojmë te prezantimi i ministrit të Energjisë, zoti Bejtja, në pyetje, përgjigje dhe në fund votimin.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1.

Në Shqipëri KfW-ja ka zbatuar bashkëpunim financiar dhe siguron grande dhe kredi të buta apo investime kyçe në infrastrukturë dhe shërbime konsulence, sidomos në fushën e energjetikës, bashkëpunim i cili ka filluar nëpërmjet shtetit gjerman dhe atij shqiptar në 1988, duke shënuar kështu 30 vjet bashkëpunim në këtë fushë. Që nga ai vit qeveria gjermane ka angazhuar më shumë se 1 miliard euro financime për infrastrukturë, energji dhe më gjerë. Unë gjej rastin ta falënderoj dhe të shpreh vlerësimin maksimal për mbështetjen dhe bashkëpunimin ndër vite. Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1 do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes. Duhet theksuar se, megjithëse është punuar fort për nivelin e humbjeve dhe kemi një ndryshim cilësor, sërish ka humbje në rrjet për shkak të amortizimit, por mendoj se ky projekt do të influencojë në përmirësimin e këtyre treguesve që kemi arritur, rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për

klientët. Po ashtu do të mbështesë dixhitalizimin e rrjetit të OSHEE-së, duke përmirësuar dhe zgjeruar qendrën e kontrollit dhe të shpërndarjes me pajisje dhe aparatura bashkëkohore.

Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike do të përmirësojë jo vetëm cilësinë e energjisë, por dhe nivelin e humbjeve për qytetarët, pra do të ketë efekt edhe në përmirësimin e klimës së biznesit dhe në kushtet e jetesës në Shqipëri. Vetëm para pak kohësh ne kaluam marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila i paraprin ratifikimit të kësaj marrëveshjeje financiare, sipas së cilës qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësinë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga KfW-ja për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike” shumën që do ta them tani.

Sigurisht që i gjithë ky investim është goxha i madh dhe unë do të doja të shprehja edhe një herë konsideratën për mbështetjen e qeverisë gjermane, bëhet fjalë për 30 milionë euro hua, që do të përdoret për financimin e këtij projekti. Sa i përket normës së interesit, besoj se edhe zëvendësministri do të na japë detaje, nuk është përcaktuar, por deri tani ka qenë 1 deri në 2% dhe nuk besoj se do të kemi një normë interesi më të lartë në këtë rast. Për shkak të ndikimit që do të ketë nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje në përmirësimin e gjithë këtyre treguesve që përmenda, u kërkoj kolegëve që ta mbështesin dhe ta votojmë njëzëri.

Niko Peleshi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Fjala për ju, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Përshëndetje!

Marrëveshja, ashtu siç tha dhe deputetja, vjen pas miratimit të marrëveshjes ndërqeveritare për përfshirjen e këtij financimi në kuadrin e financimeve të sektorit, të mbështetura nga qeveria gjermane nëpërmjet bankës KfW. Kjo marrëveshje ka nisur si aplikim qysh në vitin 2016, ka qenë pjesë e programit të akorduar mes dy qeverive për financimin e sektorit, por me kërkesë të Ministrisë së Financave është insistuar dhe vendosur që të ishte e lidhur edhe me performancën e OSHEE-së, pra ne do të mund ta bënim të realizueshme këtë marrëveshje vetëm nëse do të kishim arritur treguesit e duhur të performancës ekonomiko-financiare.

Tani jemi në kushtet kur KfW-ja është e gatshme ta financojë projektin, kuptohet që do të jetë gjithmonë brenda programit mes dy qeverive dhe është e ndarë në tri lote financimi, 3 herë nga 10 pa cenuar tavanet e buxhetit. Kështu që jemi brenda zonës së mbulimit për sektorin e energjisë elektrike.

Ashtu siç tha edhe deputetja, shtrihet në rrjetin e shpërndarjes në sistemin e saj dhe në sistemin e komanduar të kontrollit të rrjetit të energjisë SKADA.

Fillimisht do të bëhet e mundur në dy zonat pilot për SKADA-n, në Tiranë dhe Durrës dhe pjesa tjetër janë rrjet 20 kilovolt 04 ABC dhe nënstacionet, që do të fuqizohen për ta bërë këtë rrjet më të sigurt. Kuptohet që një kontroll i tillë i automatizuar i sistemit nuk mund të jetë efektiv dhe eficient nëse ne nuk ndërhyjmë edhe në rrjet. Ai i bashkohet të gjithë programit të investimeve që kemi në rrjetin e shpërndarjes, i cili është miratuar në planin e konsolidimit financiar. Vetë OSHEE-ja do të jetë me një tavan deri në 7.75 miliardë lekë në vit, kurse pjesa tjetër do të jenë financime që do t'i realizojmë nëpërmjet mbështetjes nga buxheti i shtetit me garanci sovraane, pra kredi deri sa të mos kemi më nevojë të marrim mbështetje nga garancitë qeveritare, por të financojmë vetë të gjithë rrjetin.

E kemi bërë të mundur këtë hap që në vitin 2017, kur për herë të parë kemi marrë notë pozitive nga vlerësimi i ekspertëve ndërkombëtar dhe vendas për auditimin e programit ekonomik të vitit 2017. Tani presim një rezultat akoma më të suksesshëm për auditimin, vlerësimin dhe certifikimin e atij të vitit 2018, që do të dalë së shpejti. Pra shkojmë drejtë një rruge e cila do ta bëjë këtë ndërmarrje akoma më të pavarur për të qenë pjesë e tregut qoftë nga pikëpamja ekonomike ashtu dhe e konkurrencës për sa i përket hapjes së tregut dhe derregullimit të tij në shitjen dhe blerjen e energjisë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Baraj ka një pyetje.

Besnik Baraj – U përmend këtu që mund të këtë ndikim edhe në uljen e humbjeve. A keni ndonjë parashikim se sa ky investim luan rol në uljen e humbjeve?

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Në radhë të parë edhe unë do të doja të falënderoja qeverinë gjermane për mbështetjen e madhe që na jep, sidomos në sistemin energjetik dhe më vjen shumë mirë që i gjithë rrjeti ynë arriti të plotësojë kriteret e duhura që të fillojnë disbursimet e këtyre lloj kredive! Sigurisht që të arrish këto lloj treguesish në një kohë të shkurtët të paktën një falënderim është i merituar. Ajo që doja të pyesja ka të bëjë me faktin që komponenti i parë SKADA është për Tiranën dhe Durrësin, kurse dy komponentët e tjerë janë të lidhura më të parin. Këto investime do të përqendrohen në këto dy rajone apo i kemi të shtrira edhe në rajone të tjera?

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kisha një pyetje në vijim të asaj që tha zoti Pëllumbi. Te komponenti i dytë janë përfshirë ndërhyrje tek nënstacionet ose ndërtimi i nënstacioneve të reja. A është përcaktuar se ku do të ndërtohen këto? Ku do të ketë përforsime apo rikonstruksione të nënstacioneve?

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Pyetja imë është në vazhdim të asaj që tha kolegu Marto, sepse në relacion në komponentin e tretë flitet për zona të përzgjedhura. A mund të na jepni informacion se cilat janë ato? A jeni në gjendje të na thoni se sa fonde do të marrë secili nga këta komponentë nëse e gjitha është 30 + 2?

Te shtesat, kur ju na shpjeguat që fillimisht te SKADA do të pilotoni, ky investim zgjidh nevojat e SKADA-s për të gjithë vendin apo do të na duhet të investojmë edhe në të ardhmen?

Sa mund të jetë ajo që duhet për të gjithë SCADA-n e të gjithë Shqipërisë. Pak a shumë, për sa vite mendohet që mund të zbatohen të gjitha këto?

Niko Peleshi – Edhe një pyetje tjetër.

Ilir Beqaj – Në fakt, kjo është më shumë pyetje teknike. Sa është shuma totale e interesave që KfW do të përfitojë në fund të periudhës kur maturohet kjo kontratë shlyerjeje? Kalendar i përdorur përgjatë gjithë periudhave është PMT, nëse keni bërë marrëveshje të tillë, apo pagesë standarde me interesa të pandryshueshme gjatë gjithë periudhës?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Nëse nuk ka pyetje të tjera, fjalën e ka zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Për sa i përket pyetjes së parë, nëse mund të ketë ndikim në uljen e humbjeve, ka 2 vjet që çdo investim që ne bëjmë është i lidhur me dy sisteme, të cilët vlerësojnë përmirësimin e cilësisë së furnizimit dhe të uljes së humbjeve në rrjet. Në dijeninë time, për çdo 10 milionë euro investim, ne llogarisim nga 0,3-0,5% ulje. Pra, një kredi e tillë do të mund të ulë humbjet maksimumi deri në 2%, por nuk shkon e gjitha për rrjet shpërndarjeje.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së deputetit Beqaj, ka një strukturë të tillë, rreth 18 milionë euro, për nënstacione dhe rrjet shpërndarjeje 20 kilovolt dhe 0,4 kilovolt. Ka një investim 4-5 milionë euro për sistemin SCADA, pilotimin e tij në tension të mesëm dhe pjesa tjetër është për ndërhyrje në 2 ose 3 nënstacione. Të gjitha janë të përcaktuara.

Ne nuk kemi vlerësuar vetëm projektet që janë të lidhura me këtë kredi, por pothuajse kemi të qartë të gjithë hartën e ndërhyrjeve në rrjetin e shpërndarjes në Shqipëri, të prioritizuar qoftë për nga vjetërsia dhe nga vulnerabiliteti, por edhe nga ngarkesa.

Zona për të cilën ne flasim është tejte e ngarkuar. Ne kemi bërë investime, të cilat kanë ndihmuar në lehtësimin e operimit të rrjetit të shpërndarjes, duke bërë të mundur që të lidhen në të edhe konsumatorë të rinj. Vazhdojmë të punojmë përsëri në këtë drejtim, sidomos për zonën në qendër të Tiranës, e cila do të bënte të mundur një balancim të konsumit, duke pasur parasysh edhe zhvillimin e ardhshëm të Tiranës në qendër. Kjo do të ndihmojë edhe në uljen e humbjeve, sepse shpërndarja e ngarkesës bën edhe një menaxhim më të mirë të humbjeve në rrjet.

Për sa i përket pyetjes se çfarë përfshin komponenti SCADA, tashmë ne e kemi bërë qendër dispeçer me një investim rreth 5 milionë euro dhe kemi regjistruar në të të gjithë operatorët 35 kilovolt, pra, në tension të lartë, dhe jemi duke planifikuar të pilotojmë disa fidra në tension të mesëm në zonën Tiranë-Durrës. Projekti për të gjithë vendin, që të futet në sistem të automatizuar kontrolli, shkon rreth 52-55 milionë euro. Nuk do të presim të kemi vetëm financime nga partnerët tanë ose mbështetje nga Ministria e Financave, por edhe me para të vetë OSHE-së. Pra, projekti pritet të mbyllet në harkun e vitit 2022, me qëllim që e gjithë Shqipëria të jetë në sistem të automatizuar kontrolli.

Më tej jemi duke pilotuar katër fidra, të cilët do të jenë me matje dixhitale dhe kontroll në distancë. Nëse kjo do të rezultojë e suksesshme, do të mundohemi ta shtrijmë në segmente dhe në zona në të gjithë vendin, atje ke kemi rrjetin më të përshtatshëm për këtë punë. Nuk është e lehtë të bësh matje dixhitale me linjë ajrore. Pra, duhet që humbjet të jenë në një nivel të caktuar, investimi të jetë i kompletuar 110 kilovolt, 20 kilovolt dhe 04 kilovolt, që edhe transmetimi i energjisë të jetë në standarde të larta si për impulset që japin informacion, ashtu edhe për furnizimin e konsumatorëve deri në fundor.

Për sa u përket nënstacioneve, kemi disa nënstacione ku ne mund të ndërhyjmë. Projekti në fjalë bën fjalë për 3 nënstacione. Pavarësisht se është me mbështetje qeveritare, kjo është kredi biznesi me interesa të një kredie të butë, jo më shumë se 1,2% në vit.

Shlyerja është për mbi 15 vjet dhe ka një vit ...

Lidhet me zbatimin e projekteve dhe ka kosto lokale. I gjithë investimi nuk mbaron me 30 milionë euro. Një pjesë e tij mbulohet me kredi, kurse pjesa tjetër me investime të vetë kompanisë. Zonat e përzgjedhura nuk i di, por, nëse doni, mund t'jua sigurojmë si informacion. Janë tre nënstacione në zonën Tiranë -Durrës ku është edhe rreth 60% e konsumit të Shqipërisë.

Niko Peleshi – Ju lutem na i dërgoni si informacion, meqenëse u kërkuan në komision.

Ilir Bejtja - Përveç kredisë, janë parashikuar edhe dy milionë euro asistencë teknike, të cilat do të mbulojnë mbështetjen e projektit me vlerësime të nevojshme për secilin prej projekteve që do të paraqitet.

Niko Peleshi – Pati edhe një pyetje se si shpërndahet ndërmjet komponentëve. Rreth 18 milionë do të shkojnë në shpërndarje, kurse pjesa tjetër për sistemin SCADA dhe dy nënstacione.

Niko Peleshi – Zoti Valteri dhe zoti Pëllumbi kanë nga një pyetje shtesë.

Halit Valteri – Duke marrë parasysh treguesit e mësipërm, si paraqitet situata aktuale, ndërkohë që OSHEE-ja ka rritur ndjeshëm importin e energjisë elektrike dhe KESH ka ulur prodhimin? Sa ka shkuar fatura e importit deri tani? Mendoj që duhet të bëhet transparente për shqiptarët.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Ndoshta unë e mora përgjigjen për pyetjen time indirekt, por dua ta thelloj pak më tej. Me këto investime në dy zonat që do pilotojmë, ne e mbyllim 20 kilovotshin apo do të kemi nevojë edhe për investime të tjera?

Ilir Bejtja – Po e nis nga pyetja e dytë, meqenëse është vazhdimi i të parave. Që ne të përfundojmë të gjithë Shqipërinë me 20 kilovolt, as këto dy zona, që përfaqësojnë rreth 60% të konsumit të peshës së rrjetit në total... Në të gjithë Shqipërinë vetëm 11% e rrjetit është 20 kilovolt, kurse pjesa tjetër është 6, 10 dhe 0,4 me linjë ajrore. Pra, minimumi ne duhet të investojmë 700-800 milionë euro që ta kemi të gjithë Shqipërinë në këto kushte. Megjithatë, kemi ndërhyrë në vende ku ne jemi më vulnerabël, ku konsumi është shumë i lartë, intensiteti i ndërtimeve është shumë i lartë, zonë me konsum të përhershëm, jo sezonale, pra ku kemi kryesisht ngarkesa permanente.

Për sa i përket pyetjes së parë, e cila lidhet me performancën e sistemit, mendojmë që performanca është përmirësuar ndjeshëm. Kemi arritur në një pikë që ne mund të flasim për performancë, që tashmë është patjetër e lidhur me investime. Pra, nuk mund të shkojmë më në uljen e humbjeve thjesht duke dalë me policë në rrugë, por duhet patjetër ta shoqërojmë me investime në rrjet, në mënyrë që të kemi rezultate optimale për shpërndarjen dhe cilësinë e furnizimit me energji. Jemi në termat e rreth 65-66 miliardë lekëve shitje energjie, krahasuar me rreth 32 që kemi pasur në vitin 2013. Pra, pak më shumë se dy herë. Në vitin 2013 kemi shitur rreth 3,4 terravat, kurse tani shesim rreth 5 terravat. Pra, i kemi ulur humbjet.

Treguesi i humbjeve dhe treguesi i arkëtimeve janë tregues që kryqëzojnë njëri-tjetrin. Pra, nëse do të rrisnim fiktivisht njërin tregues, do të dëmtonim tjetrin. Në të dy treguesit jemi

me nivele shumë të larta rritjeje. Përsëri kemi shumë për të bërë. Janë të lidhura kryesisht me investime. Megjithatë, kemi marrë edhe masa organizative për të përmirësuar performancën. Tashmë ka filluar një kontratë për menaxhimin e lartë të kompanisë me asistencën e një kompanie të zgjedhur nga KfW-ja. Gjithashtu, jemi duke përforcuar monitorimin dhe kontrollin jo më të konsumatorëve, por të vetë punonjësve të kompanisë. Kemi ngritur një njësi operative brenda OSHEE-së, e cila është e shtrirë në të gjithë vendin. Nëpërmjet këtyre mekanizmave mundohemi të kemi në kontroll të gjithë rrjetin.

Gjithashtu, zonën elektrike të Shkodrës, e cila është quajtur si më e vështira e mundshme që ne kemi në territorin e Shqipërisë për sa i përket informalitetit dhe humbjeve, e kemi zgjedhur si zonë pilot për një projekt, që dikur e kemi quajtur projekti i USAID-it ose fidrave, ku kemi shtuar prezencën në terren, kemi përmirësuar sistemin e faturimit dhe çdo element për të parë se deri ku mund të arrijmë pa investime. Pra, vetëm me pjesën operacionale.

Halit Valteri – Zotëri, ju thatë që keni 65-66 miliardë lekë shitje. Sa energji ka blerë OSHEE-ja?

Ilir Bejtja – Kjo nuk ndikon në fund të konsumatori, prandaj edhe unë ju dhashë këto elemente. Është problem që lidhet me OSHEE-në. Për sa i përket pyetjes sa energji kemi blerë deri tani, shifrat e 5-mujorit janë rreth 102 milionë euro energji. Kjo lidhet me mungesën e reshjeve. Flasim për një periudhë ku niveli në liqenin e Fierzës ka qenë rreth 19 metra nën rregullore.

Në momentin që flasim Fierza është në nivelin mbi 290 metra dhe ne jemi duke optimizuar midis dy ndërmarrjeve për eliminuar importet në pik, duke marrë prodhim nga KESH-i gjatë gjithë verës dhe duke importuar në bandë, Waysload. Nëse do të arrijmë të kemi një kontroll siç e kemi pasur deri tani, mendojmë që deri në fund të sezonit të verës të kursejmë rreth 14 milionë euro. Në këto momente ne flasim për një sistem energjie, i cili përdor shumë komponentë për të kursyer 1 milionë, 2 milionë, 3 milionë. Nuk jemi më në vitin 2015 kur hopi në të ardhura ishte nga 33 miliardë lekë në 54-55 miliardë lekë. Pra, kemi arritur në përpjekje të sofistikuara.

(Mungesë incizimi)

290 metra kemi hyrë në datën 6 qershor. Jemi përsëri nën kuotë, duke pasur parasysh që rregullorja në maj-qershor është 297 metra. Megjithatë, punojmë jo më shumë se sa prurjet natyrale.

Situata për qershorin do të mbetet konstante, ku ne të mund të kemi importe të rregulluara vetëm Waysload, kurse në pik të prodhojmë nëpërmjet Fierzës. Po kështu do të vazhdojmë edhe në korrik dhe në gusht.

Megjithatë, për qytetarët dhe për të gjithë bizneset, të cilët e kanë me merak sezonin, ashtu, siç kemi bërë në 2 vite, që kanë qenë shumë të vështira për ne, 2017 dhe 2018, edhe ky vazhdon të jetë i tillë, ne do të garantojmë 100% furnizim me energji elektrike për të gjithë konsumatorëve tanë, qofshin këta të subvencionuar, familjarë, pavarësisht me tarifë të rregulluar, apo edhe biznese në të gjitha nivelet e aksesit në rrjet.

E rëndësishme është që çmimi nuk ndryshon.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Kalojmë në miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”.

Kush është dakord në parim? Kundër? 4 vota kundër Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? 4 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Pro? Kundër? 4 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shumë faleminderit, zotit Bejtja, dhe të gjithë anëtarëve për pyetjet dhe komentet!

MBYLLET MBLEDHJA